



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 6287/

Tirane, date 20/01/2017

Drejtuar: Z. FATMIR KUÇI
SHOQERIA "VIKTORIA INVEST INTERNATIONAL
LAGJIA "28 NENTORI", RRUGA "11 NENTORI",
PRANE TATIM-TAKSAVE, KATI I DYTE

ELBASAN

Për njoftim: ZNJ. PRANVERA FAGU, DREJTOR I PERGJITHSHEM
QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT
BULEVARDI "ZHAN D'ARK" PRANE MINISTRISË SE JASHTME

TIRANE

Z. VIKTOR TUSHAJ, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. ALFRED KALO, DREJTOR I KOMANDUAR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.1673 date 06.09.2013

I nderuar z. Kuçi,

Shoqëria "Viktoria Invest International" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1673 date 06.09.2013 për mineral kromi, ne objektin "Katjel", Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

Me vendimin e këshillit teknik te Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore (AKBN) nr.512 date 19.09.2016, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6287 date 18.10.2016 "Për shqyrtim dhe vlerësimin e procedurave te mbylljes se lejes minerare te shfrytëzimit nr.1673 date 06.09.2013 ne objektin e mineralit te kromit "Katjel", Prrenjas, Librazhd te subjektit Viktoria Invest International" është bere miratimi i kërkesës se shoqërisë tuaj, për mbylljen e lejes nr.1673 date 06.09.2013 ne objektin "Katjel", Bashkia Prrenjas.

Ne këtë vendim përcaktohet qe te behet miratimi i mbylljes se lejes se shfrytëzimit nr.1673 date 06.09.2013, pasi shoqëria te kryej pagesën ne shumën 3 915 485 leke, për rehabilitimin e mjedisit.

Vendimi i AKBN-se për revokimin e lejes nr.1673 date 06.09.2013 është bere sipas kërkesës tuaj, ne përputhje me piken nr.2 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes**

minerare te shfrytëzimit 1673 date 06.09.2013 ne objektin e mineralit te kromit “Katjel”, Prrenjas, Librazhd qe shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes minerare te shfrytëzimit 1673 date 06.09.2013 ne objektin e mineralit te kromit “Katjel”, Prrenjas, Librazhd, pasi nga ana e shoqërisë tuaj te jete bere pagesa ne shumen 3 915 485 leke për rehabilitimin mjedisor.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NE MUNGESHE DHE ME POROSI

ZEVENDESMINISTRI

ILIR BEJTJA

